

VENDIM
Nr. 110, datë 6.3.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.339, DATË 1.6.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SISTEMIMIN ME MJEDISE PUNE TË DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 339, datë 1.6.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemimin me mjedise pune të disa institucioneve shtetërore dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, pas pikës 3, shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Mjediset në përgjegjësi administrimi të Komitetit Shtetëror për Kultet janë sipas formularit 1 (një) fletë dhe planimetrive 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”.

2. Ngarkohen Komiteti Shtetëror për Kultet dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Institucioni Qendror Shtetëror: **Komiteti Shtetëror për Kulturë**

Identifikoi pronën: *Motela Goga, identitet e s*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: *Klodan Basha*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovui: *Klodan Basha*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., faks, e-mail)

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronë pasurisë	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni që disponon pasurinë inventarizuar me VKM 339 Statusi i objektit i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shenime të veçanta)
						Truall (m2)	Ndertese (m2)				
1	ZK 8350	Pjesë e pasurisë 6/217	Njësi	Komiteti Shtetëror për Kulturë Bulevardi Zogu I			28.6	Administrative	Komiteti Shtetëror për Kulturë	Komiteti Shtetëror për Kulturë	VKM 339 Date 1.6.2004 Sipërfaqe prej 23 m2, ndërtim informal
2	ZK 8350	Pjesë e pasurisë 6/217	Njësi	Komiteti Shtetëror për Kulturë Bulevardi Zogu I			105	Administrative	Komiteti Shtetëror për Kulturë	Komiteti Shtetëror për Kulturë	VKM 339 Date 1.6.2004



KRYETAR
Klodan Basha
KOMITETI SHËTETËROR PËR KULTURË

